L I G J
Nr.9140, datë 16.10.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES USHTARAKE, GRANT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ushtarake, grant, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3996, datë 6.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
USHTARAKE, GRANT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë:
duke rikonfirmuar edhe një herë marrëdhëniet e tyre miqësore;
duke iu referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushat ushtarake të stërvitjes, teknikës dhe shkencës të datës 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit për stërvitjet ushtarake të datës 19.11.1992 dhe me qëllim të forcimit të bashkëpunimit të tyre ushtarak dhe për të kontribuar në ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 3 600 000 000 000 lira turke ekuivalente në dollarë amerikanë, Qeverisë së Republikës të Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2003.

Neni 2

Granti prej 3 600 000 000 000 lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet në materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Granti prej 3 600 000 000 000 lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik, i cili do të nënshkruhet ndërmjet zyrtarëve të të dyja

Palëve të referuara në këtë Marrëveshje. Republika e Turqisë nuk do të paguajë asnjë detyrim në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord mos t'ia transferojë titujt apo zotërimin e artikujve/shërbimeve një vendi tjetër ose Pale të tretë për sa kohë nuk është marrë miratimi paraprak i Republikës së Turqisë.

Neni 5

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga Palët, lidhur me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme për ratifikimin në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha materialet dhe shërbimet e specifikuara në protokollin e zbatimit t'i jenë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Qeverisë të Shqipërisë.

Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me diskutime dhe bisedime të Palëve.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në shqip, turqisht dhe anglisht. Në rast të mosmarrëveshjeve, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i saj do të jetë prioritar.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më 15.7.2003 në Ankara, Turqi.